

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch  
Sulejman Vokshi, No. 14  
Pristina  
Kosovo

Telephone +381 38 246 771  
Telefax +381 38 246 772  
E-mail [al-kosovo@kpmg.com](mailto:al-kosovo@kpmg.com)  
Internet [www.kpmg.al](http://www.kpmg.al)

**RAPORTI I AUDITIMIT**

**PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË  
ISTOGUT PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2011**

*Ky përkthim është vetëm për qëllime informimi. Varianti anglisht i cili është edhe origjinali  
ka prioritet mbi të*

**Prishtinë, Korrik 2012**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>I.</b>	<b>Përmbledhje e përgjithshme.....</b>	<b>1</b>
<b>II.</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>3</b>
<b>III.</b>	<b>Opinionit i auditimit.....</b>	<b>5</b>
<b>IV.</b>	<b>Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....</b>	<b>8</b>
<b>V.</b>	<b>Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar .....</b>	<b>9</b>
<b>VI.</b>	<b>Pasqyrat financiare .....</b>	<b>11</b>
VI.1	Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm .....	11
VI.2	Cilësia e informatave .....	11
<b>VII.</b>	<b>Ekzekutimi i Buxhetit .....</b>	<b>12</b>
VII.1	Të hyrat ( duke përfshirë ato vetanake) .....	12
VII.2	Shpenzimet.....	13
VII.3	Subvencionet dhe transferet .....	14
VII.4	Pasurit dhe Borxhet.....	14
<b>Të Gjeturat .....</b>	<b>15</b>	
<b>Të Gjeturat .....</b>	<b>16</b>	
<b>VIII.</b>	<b>Kontrolli mbi menaxhimin .....</b>	<b>17</b>
VIII.1	Sistemet e Kontrollit të Brendshëm .....	17
VIII.2	Auditimi i Brendshëm.....	18
<b>IX.</b>	<b>Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës së Istogut.....</b>	<b>19</b>
<b>Shtojca 1.</b>	<b>Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit .....</b>	<b>20</b>
<b>Shtojca 2:</b>	<b>Rekomandimet e vitit paraprak .....</b>	<b>22</b>
<b>Shtojca 3.</b>	<b>Komentet e Menaxhmentit të Komunës së Istogut dhe përgjigjja e KPMG-së</b>	

## I. Përmbledhje e përgjithshme

KPMG ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare ("PVF") të Komunës së Istogut ("Komuna") në emër të Zyrës së Auditorit Gjeneral të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Me poshtë gjeni një ekstrakt të marrë nga opinionit i auditorit në faqet 5 - 7 të këtij dokumenti.

"Sipas mendimit tonë, përveç mungesës së informacionit të përshkruara në paragrafet e bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale të hyrat dhe pagesat për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2011 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për "*Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme* dhe me Rregulla financiare nr 07/2011 *Mbi Raportimin Vjetor të Organizatave buxhetore*".

Mesazhet kryesore ndaj Kryetarit, që rezultuan në kualifikim të opinionit janë:

- 1 Pagesat nga palët e treta të shpalosura nga Komuna në Nenin 12, *Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit* nuk janë complete dhe të sakta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operacionale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë të kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2011, 2010 dhe 2009.
- 2 Komuna nuk ka shpalosur shumat lidhur me pronat, ndërtesat dhe pajisjet në shënimin 30 të pasqyrave financiare. Në vend të kësaj Komuna ka shpalosur pjesërisht këto shuma në shtojcën 2 të pasqyrave financiare. Për më shumë Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës, në Kadastër apo në Gjykatë.
- 3 Shënime të caktuara në pasqyrat financiare nuk janë përgaditur në harmoni me kërkesat e rregullit financiar 07/2011.
  - Shënimi 28, "*Raporti përmbledhës i obligimeve sipas LPMFP*" nuk barazohet me shënimin 28 "*Raporti i detajuar i obligimeve sipas LPMFP*"
  - Shënimi 29 "*Detyrimet kontigjente*" nuk është përfunduar, megjithatë menaxhmenti i Komunës konfirmon se ekzistojnë konteste gjyqësore në proces që mund ti rrisin detyrimet kontigjente.
  - Shënimi 31 "*Përmbledhja e pasurive jo-financiare me vlerë më të vogël se EUR 1,000 me jetëgjatësi më shumë se një vit*" nuk është plotësuar.
  - Shënimi 34 "*Të arkëtueshmet*" është plotësuar pjesërisht.

- Informacioni krahasues që duhet prezantuar në shënimet 30 deri 34 për vitet 2010 dhe 2009 nuk është shpalosur.

## **Kontrolli i brendshëm**

Auditimi ynë ka identifikuar mangësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto mangësi janë përshkruar me detaje në këtë raport.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës nuk është dizajnuar dhe implementuar në mënyre të duhur për eliminim e dobësive evidente. Kjo do të duhej të adresohet për të përmirësuar performancën e Komunës.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguron:

- Të mbahet një listë e plotë e pronave, impianteve dhe pajisjeve të Komunës;
- Të mbahet një sistem faturimi automatik për të gjitha llojet e taksave;
- Të barazohen të hyrat në mes zyrtarit të të hyrave vetanake dhe departamenteve operacionale;
- Aktivitetet e prokurimit të udhëhiqen në harmoni me ligjet nr. 03/L -241 dhe 04/L-042 ‘Ligji i Prokurimit Publik’; dhe
- Të themelohet Komiteti i Auditimit.

Ne i kemi dhënë mundësinë menaxhmentit të Komunës që të shprehin komentet e tyre lidhur me të gjetjet tona në këtë dokument. Menaxhmenti i Komunës së Istogut i ka pranuar gjetjet dhe konkluzionet tona të paraqitura në raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare për vitin 2011 dhe është zotuar që do të bëjë të gjitha përpjekjet për t’i adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Në Shtojcën 3 mund të gjeni komentet e Komunës mbi rekomandimet tona dhe përgjigjet tona ndaj tyre.

## II. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës së Istogut të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregullit Financiar 07/2011 dhe në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

KPMG, në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor, në dhe për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2011 për Komunën.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer një vlerësim preliminar të Komunës. Gjatë këtij vlerësimi, kemi rishikuar pasqyrat financiare për periudhën që përfundon me 30 Shtator 2011 dhe vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me kërkesat e tyre me rregullin financiar 06/2011, adresimin e rekomandimeve tona të mëparshme nga Komuna si dhe cilësinë e menaxhimit financiar nepermjet plotësimit të pyetsorit shendetesor. Bazuar në këto kemi keshilluar menaxhmentin. Rekomandimet tona kanë të bëjnë me përmirësimet që duhet të bëhen në lidhje me pasqyrat financiare që të jenë në përputhje me Udhëzimin Administrative 07/2011 dhe Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për Raportimin Financiar të Kontabilitetit në baza Keshi. Rekomandimi ynë është dorëzuar përmes një audit memorandumi në datë 20 Dhjetor 2011.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar në dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”; dhe Rregullën Financiare 07/2011.
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare

- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2011.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës, standartet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1 që përmban një ekstrakt nga ISSAI 4000.

### III. Opinioni i auditimit

Për: Komunën e Istogut

Prishtinë, 2 Korrik 2012

Ne kemi qenë të angazhuar në auditimin e pasqyrave financiare të Istogut ("Komuna"), që përbëhen nga pasqyra e pranimit dhe pagesave të kesh-it per fund vitin 31 Dhjetor 2011, një krahasim të shumave të buxhetuara dhe aktuale, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontable dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

#### *Përgjegjësia e Menaxhimit për Pasqyrat Financiare*

Menaxhimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ('SNKSP') – *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullin Financiar Nr. 07/2011 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

#### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me Standartet ndërkombëtare të publikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Udhëzimeve Supreme të Auditimit (ONUSA). Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur deri të një siguri e arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të grumbulluar dëshmi auditimi për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi jonë, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne e marrim në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllimin për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të siguruar një një bazë për opinionin tonë të kualifikuar.

#### *Baza për një Opinion të Kualifikuar*

1. Pagesat nga palët e treta të shpalosura nga Komuna në Nenin 12, *Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit* nuk janë complete dhe të sakta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operacionale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë të kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011, 2010 dhe 2009.

2. Komuna nuk ka shpalosur shumat lidhur me pronat, ndërtesat dhe pajisjet në shënimin 30 të pasqyrave financiare. Në vend të kësaj Komuna ka shpalosur pjesërisht këto shuma në shtojcën 2 të pasqyrave financiare. Për më shumë Komuna nuk ka një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të pronave të saj të patundshme duke përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e këtyre pronave dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emër të Komunës, në Kadastër apo në Gjykatë.
3. Shënime të caktuara në pasqyrat financiare nuk janë përgaditur në harmoni me kërkesat e Rregullit Financiar 07/2011.
  - Shënimi 28, “Raporti përmbledhes i obligimeve sipas LPMFP” nuk rikoncilion me shënimin 28 “Raporti i detajuar i obligimeve sipas LPMFP”
  - Shënimi 29 “Detyrimet kontigjente” nuk është përfunduar, megjithatë menaxhmenti i Komunës konfirmon se ka konteste në proces që mund ti rrisin detyrimet kontigjente.
  - Shënimi 31 “Përmbledhja e pasurive jo-financiare me vlerë më të vogël se EUR 1,000 me jetëgjatësi më shumë se një vit” nuk është plotësuar.
  - Shënimi 34 “Të arkëtueshmet” është plotësuar pjesërisht.
  - Informacioni krahasues për vitet 2010 dhe 2009 në shënimin 9 të Pasqyrave Financiare nuk ja shpalosur.
  - Informacioni krahasues që duhet prezantuar në shënimet 30 deri 34 për vitet 2010 dhe 2009 nuk është shpalosur.

#### *Opinion i kualifikuar*

Sipas opinionit tonë, përveç për mangësisë në informacionet e përshkruara në paragrafet për bazat për kualifikim të opinionit, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sigurtë në të gjitha aspektet materiale pagesat dhe pranimet për vitin 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme (‘SNKSP’) *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullen financiare Nr. 07/2011 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*.

#### **Rishikimi i përputhshmërisë**

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare, në të gjitha aspektet materiale, janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat

#### *Përgjegjësia e Audituesve*

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin



tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

#### *Konkluzion për Përputhshmërinë*

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

#### *Çështje të tjera*

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

1. Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Për me tepër, pasi që Komuna nuk ka përdorur Free Balance për të regjistruar pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet dhe faturat e papaguara, atëherë ky nuk mund të përdoret vetëm për të prodhuar pasqyra të plota financiare.
2. Megjithëse Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar kanë nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk kishte dorëzuar një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe më 31 Janar 2012.
3. Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, dhe nuk mban lista apo llogari të vecanta për të gjithë debitorët e saj për detyrime të lidhura me taksa të ndryshme. Vetëm arkëtimet në para të gatshme nga të hyrat regjistrohen. Megjithëse llogaritë e arkëtueshme kërkohen të shpalosen në pasqyrat financiare, Komuna nuk i ka shpalosur ato sic duhet. Mungesa e saktësisë dhe plotësisë së tyre do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë dhe në aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.
4. Komuna nuk ka mbajtur listë të plotë të pagesave nga palët e treta. Evidencat e disponueshme dhe kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për tu siguruar se pagesat nga palë të treta prezantohen dhe menaxhohen në përputhje me legjislacionin përkatës dhe përdoren për qëllimin e synuar nga legjislacioni, ishin të limituara.

*KPMG Albania Shpk Kosovo Branch*

KPMG Albania Sh.p.k. – Dega Kosovë  
14, Sulejman Vokshi Street  
Prishtinë  
Kosovë

## **IV. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara**

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të fundvitit 31 Dhjetor 2011 janë dhënë pesë rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, njëra që ka të bëjë me shpenzimet (pagat dhe mëditjet dhe shpenzimet tjera) është adresuar pjesërisht ndërsa të tjerat janë në proces të implementimit, për çështjet siç janë:

- Pasqyrat Financiare duhen përgaditur në përputhje me udhëzimet administrative aktuale dhe SNKSP;
- Të mbahet një listë e plotë e ndërtesave, impianteve dhe pajisjeve të Komunës;
- Të mbahet një sistem faturimi automatik për të gjitha llojet e taksave, duhet të kryhet barazimi i të hyrave në mes të zyrtarit të të hyrave dhe departamenteve operacionale. Gjithashtu duhet të merren masa për ngritjen e nivelit të mbledhjes së taksave.
- Procedurat e prokurimit duhen kryer në harmoni me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.
- Të themelohet Komiteti i Auditimit

Mos adresimi i plotë i rekomandimeve tona, ka shkaktuar gjetje të ngjashme sikurse në vitin 2010.

## V. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve

Përshkrimi	<b>Buxheti Fillestar</b>	<b>Buxheti Rishikuar</b>	<b>Buxheti Final</b>	<b>2011 Realizimi</b>	<b>2010 Realizimi</b>
Të hyrat vetanake	764	-	989	855	715
Donacionet e vendit	-	-	81	50	544
Donacionet e jashtme	-	-	-	-	-
<b>I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve</b>	<b>764</b>	<b>-</b>	<b>1,070</b>	<b>905</b>	<b>1,259</b>
Rrogat dhe pagat	4,102	-	4,207	4,133	3,306
Mallra dhe shërbime	590	-	634	601	661
Shpenzimet komunale	131	-	131	130	146
Subvencionet dhe transferet	94	-	118	96	110
Investimet Kapitale	2,314	-	2,509	2,312	2,464
Rezervat	-	-	-	-	-
<b>II. Gjithsej shpenzimet</b>	<b>7,231</b>	<b>-</b>	<b>7,599</b>	<b>7,272</b>	<b>6,687</b>
<b>Ndryshimi I-II</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Shumat e buxhetuara janë marrë nga pasqyrat financiare Neni 13 “*Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit*” dhe Neni 18 Shenimi 36 “*Harmonizimi i ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit*”. Duhet thënë se nuk kishte rishikimi të buxhetit për Organizatat Buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2011.

## **Konkluzion**

Total të ardhurat aktuale dhe transferet e donacioneve ishin më të ulëta se buxheti final për 165 mijë Euro, për shkak të realizimit të të hyrave vetanake që ishin më të ulëta për 134 mijë dhe donacionet e vendit që ishin më të ulëta për 31 mijë Euro.

Realizimi ishte më i ulët se buxheti final për 327 mijë Euro për shkak të pagave dhe mëditjeve që ishin më të ulëta për 74 mijë Euro, mallërat dhe shërbimet ishin më të ulëta për 33 mijë Euro, shpenzimet komunale ishin më të ulëta për 1 mijë Euro, subvencionet dhe transferet ishin më të ulëta për 22 mijë Euro dhe shpenzimet kapitale kanë qenë më të ulëta për 197 mijë Euro.

Buxheti fillestar ishte më i ulët për 306 mijë Euro nga buxheti përfundimtar për shkak të pritshmërisë më të ulët të të hyrave vetanake dhe jo pritshmëri për donacione.

Të gjitha ndryshimet në buxhetin fillestar janë miratuar siç duhet nga Komiteti Komunal për Buxhet dhe Financa kryesuar nga Z. Dem Çeta. Këto ndryshime janë mbështetur edhe nga vendimi i kuvendit dhe të lejuara nga korniza ligjore.

Buxheti i pashpenzuar i Komunës në vitin 2011 ishte më i ulët për 4%.

## **VI. Pasqyrat financiare**

### **VI.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm**

Sipas përputhshmërisë me kërkesat e LMFP nr. 03/L-048, Ligji nr. 03/L-221 i rishikuar dhe i cili plotëson Ligjin 03/L-048 dhe Rregulla Financiare 07/2011, ne kemi vërejtur pikat në vijim:

- Komuna ka përgatitur pasqyrat financiare në pajtueshmëri me Regullën Financiare nr. 07/2011 me përjashtim të çështjeve të detajuara në opinionin e auditimit.
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore. Ato janë nënshkruar me datën 31 Janar 2012 dhe janë dorëzuar në MF;
- Pasqyrat Financiare janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF-it gjatë vitit 2011.

#### **Rekomandimi 1**

Ne rekomandojmë që Kryetari të siguroj se për përgatitjen e pasqyrave financiare të Komunës përfshihen procedurat dhe mjetet që janë të dizajnuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, i përmbledhur dhe përshtatshëm i raportuar në pasqyrat financiare.

Komuna duhet gjithashtu të përgatise pasqyrat financiare në gjuhën serbe.

Persa i përket shpalosjes së pagesave nga palë të treta, ne rekomandojmë që Komuna të mbledhë informacione nga entitete të ndryshme që kanë regjistruar këto pagesa dhe të përditësojë regjistrimet e tyre. Për më shumë për pagesat që nuk vijnë nga Ministrinë ne rekomandojmë që zyrtarët e lartë të Komunës të konfirmojnë çdo pagesë / donacion për të cilën ata kanë informacion në çdo periudhë raportuese.

### **VI.2 Cilësia e informatave**

#### **Të Gjeturat**

Vëzhgimet dhe rekomandimet tona në këtë dokument sugjerojnë se duhet të bëhen përmirësime në kualitetin e informacionit të pranuar dhe prezantuar në Pasqyrat Financiare të Komunës.

#### **Rekomandimi 2**

Ju lutem referojuni rekomandimeve tona përgjatë këtij dokumenti për këshilla se si mund të përmirësohet kualiteti i të dhënave të prezantuara në Pasqyrat Financiare

## VII. Ekzekutimi i Buxhetit

### VII.1 Të hyrat ( duke përfshirë ato vetanake)

#### Të Gjeturat

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për tatimin në pronë. Faturimet nga Komuna për lejet e biznesit dhe të ardhurat nga qeraja nuk regjistrohen. Për këto të hyra regjistrohen vetëm arketimet e parave të gatshme.
- *Mbledhja e të hyrave.* Përveç tatimit mbi pronën, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të ndarë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhshmerisë ose të përcjellë në kohë mbledhjen e të hyrave vetanake.
- *Barazimi i të hyrave.* Nuk është bërë ndonjë barazim i të dhënave të mbajtura në kontabilitet me ato të zyrtarit të të hyrave apo departamenteve operacionale për vitin 2011. Komuna nuk na ka ofruar një regjister të detajuar dhe të plotë për të hyrat nga licencat e bizneseve, në zyrën e urbanizmit dhe kadastrës, zyrës së pronës dhe qirasë, zyrës së taksave administrative dhe participimit të shkollave nga Departamenti i Edukimit. Për më shumë, nuk na është ofruar lista e kontratave të qerazë për vitin 2011.
- *Dobësitë në sistemin e faturimit automatik.* Sistemi i faturimit të tatimit mbi pronën ishte i centralizuar dhe Komuna nuk mund të rishikojë dhe monitorojë në mënyrë të duhur mbledhjen e të hyrave meqenëse ajo bëhet në mënyrë automatike nga sistemi.

#### **Rekomandimi 3**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efikente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do të mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bërë siç duhet. Ne i rekomandojmë Komunës të konsiderojë pikat si në vijim:

- Implementimin e një sistemi të faturimit që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pages. Qasje në informacion të tillë duhet të kenë vetëm një numër të limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.
- Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifën dhe normat e taksave në sistem në mënyrë që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.

- Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit.
- Të ushtrojë barazime të rregullta midis dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha tipet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda afatit të caktuar.
- Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksionesh.

## VII.2 Shpenzimet

### 2.1 Blerjet përmes prokurimit

#### Të Gjeturat

1. Në procedurën e prokurimit nr. 633-10-026R-121 prokurimi për furnizimin e institucioneve komunale me paisje të teknologjisë informative, përshkrimi i pajisjeve në faturën nr. F-10-2800/002 ishte i ndryshëm nga përshkrimi përkatës në formën e kërkesës për blerje.
2. Në procedurën e prokurimit nr. 633-10-026R-121 prokurimi për furnizimin e institucioneve komunale me paisje të teknologjisë informative ,për faturën me nr. F-10-2800/002 nuk kishte fletëdërgesë apo dokument të pranimit teknik të mallrave nga furnizuesi përkatës.

### 2.2 Blerjet te tjera

#### Të Gjeturat

Shpenzimet e regjistruara me urdhërpagesën 633/110/635 përfaqësojnë pagesa të bëra për kontratën e lidhur me H.L për ofrimin e shërbimeve të infermierisë në qendrën e kujdesit shëndetësor të Istogut për një periudhë tre mujore. Ky shpenzim është klasifikuar si mallra dhe shërbime në vend të Paga dhe Mëditje. Sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale 03/L-161 nenit nr.9: "Pagat e paguara në emër të një punëdhënësi për punën e kryer nga një punonjës nën drejtimin e punëdhënësit dhe të ardhurat e fituara nga punonjësi nga një punë e përkohshme duhet të kategorizohet si paga dhe mëditje. ".

#### **Rekomandimi 4**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

## **2.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet, )**

Nuk ka gjetje për tu raportuar.

## **VII.3 Subvencionet dhe transferet**

Nuk ka gjetje për tu raportuar.

## **VII.4 Pasurit dhe Borxhet**

### **4.1 Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj**

#### **Të Gjeturat**

Nuk ka gjetje për tu raportuar.

### **4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve**

Komuna ka bërë vetëm shpallje të pjesërishme të të arkëtueshmeve e që kërkohet me Rregullin Financiar 07/2011.

Shumat totale të vlerësuara janë regjistruar, mirëpo nuk kishte asnjë listë në dispozicion për mbështetjen e këtyre totaleve. Përveç kësaj, ne kemi vërejtur se shumë nga shumat e të arkëtueshmeve janë më të vjetra se një vit

#### **Rekomandimi 5**

Ne i rekomandojmë Komunës të sigurojë:

Shpalljen e llogarive të arkëtueshme në mënyrë të detajuar dhe që shënimi të përmbaj të dhëna të sakta mbi debitorët në mënyrë që ti mundësojë Komunës përgaditjen e një buxheti të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore. Përveç kësaj, ne rekomandojmë që Komuna ndjekë rregullisht të arkëtueshmet për të siguruar mbledhjen e tyre në kohë.



## 4.3 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

### Të Gjeturat

Komuna nuk ka një regjistër gjithëpërfshirës të pronave të patundshme dhe pajisjeve në posedim të saj. Për më tepër, Komuna nuk ka regjistruar tokën në regjistër dhe nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmërive, përfshire këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë e patundshmërisë, dhe informacion për statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadastër ose në Gjykatë.

Ne nuk u pajisëm me një dokument të saktë e të përshtatshëm numërimi fizik të mjeteve më 31 Dhjetor 2011 dhe si pasojë nuk ishte e mundur të bënim një verifikim të të dhënave në kontabilitet me të dhënat e numërimit fizik. Dokumentet e numërimit fizik të mjeteve fikse përmbajnë informata të kufizuara për ndërtesat, mobiliet dhe pajisjet e komunës, duke përfshirë bar kodet për disa asete dhe detaje për përdoruesit e tyre.

Për shkak të natyrës së këtyre të dhënave, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- Shpalosë informacionin e plotë mbi pronat, objektet dhe pajisjet në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2011; dhe
- të sigurojë barazimin e informacionit të regjistruar në kontabilitet me tabelat e vlerësimit ose me ndonjë analizë tjetër, përpara aprovimit të pasqyrave financiare.

### **Rekomandimi 6**

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve.
- Të përfshijë burime shtese në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme si praktika më e mirë në raste të tilla.
- Të bëjë numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.
- Të bëjë përpjekje shtesë në lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive.

## 4.4 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2011 ishte në vlerë prej 174 mijë Euro. Këto obligime barten për pagesë në vitin fiskal 2012.

Komuna ka prezentuar 256 fatura të papaguara në notën 28 të Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011, ndërmjet të cilave:

- 21 fatura nuk kanë të specifikuar datën ;
- 15 raste nuk posedojnë numër fature;
- 68 fatura janë prezantuar pa kode ekonomike;
- 27 fatura janë prezantuar pa përshkrim për arsyen e mospagesës ;
- 1 faturë është pa emër të specifikuar të furnizuesit; dhe
- 163 fatura nuk kanë të specifikuar datën kur duhet të paguhet.

## **Të Gjeturat**

Në përputhje me LPMFP 03/L-048, neni 39.1, Zytari Kryesor Financiar i një organizate buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë valide dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbime të furnizuara dhe / apo punë të përfunduara për organizatat buxhetore duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të faturës. Kemi vënë re se komuna ka paraqitur fatura të papaguara që lidhen me mallra dhe shërbime të cilat kanë qene të papaguara për më shumë se 30 dite në fund të vitit 2011.

### **Rekomandimi 7**

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë se komuna do të ndërmerra hapa të mëtejshme për të përmirësuar procedurat e kontrollit mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe rregulloret lokale. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të bërë pagesat brenda afatit.

## **4.5 Raportimi aktual dhe afatet kohore në procesin e përgjithshëm të buxhetimit**

Përmbushja e detyrimeve të raportimit aktual të jashtëm, si dhe procesi i sajë buxhetor:

- Kërkesat buxhetore u realizuan në kohën e duhur;
- Raportet tremujore, duke përfshirë edhe pasqyrat financiare për nëntë muaj, janë dorëzuar në kohën e duhur në MF;
- Poashtu draft plan i prokurimit është dorëzuar në kohën e duhur në MF; dhe
- Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nuk është përfunduar siç duhet në pasqyrat financiare vjetore të komunës;
- **Të Gjeturat**

Nuk ka gjetje për tu raportuar.

## VIII. Kontrolli mbi menaxhimin

### VIII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

#### Të Gjeturat

Informacion parësor në të cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është Free Balance. Meqenëse Free Balance nuk është duke u përdorur për të regjistruar pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet apo faturat e papaguara, nuk mund të përdoret vetëm për të prodhuar pasqyra financiare gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2011.

Shënimet si në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare për periudhën e mbaruar me 31 Dhjetor 2011:

- Pagesat nga palët e treta të shpalosura nga Komuna në Nenin 12, *Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit* nuk janë komplete dhe të sakta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operationale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë të kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2011, 2010 dhe 2009.
- Shënimi 28, *“Raporti përmbledhës i obligimeve sipas LPMFP”* nuk barazohet me shënimin 28 *“Raporti i detajuar i obligimeve sipas LPMFP”*
- Shënimi 29 *“Detyrimet kontigjente”* nuk është përfunduar, megjithatë menaxhmenti i Komunës konfirmon se ka konteste në proces që mund ti rrisin detyrimet kontigjente.
- Shënimi 30 *“Përmbledhja e pasurive kapitale jo-financiare (me vlerë më të madhe se EUR 1,000) në posedim të organizatës buxhetore”* nuk është plotësuar;
- Shënimi 31 *“Përmbledhja e pasurive jo-financiare me vlerë më të vogël se EUR 1,000 me jetëgjatësi më shumë se një vit”* nuk është plotësuar.
- Shënimi 34 *“Të arkëtueshmet”* është plotësuar pjesërisht.
- Informacioni krahasues që duhet prezantuar në shënimet 30 deri 34 për vitet 2010 dhe 2009 nuk është shpalosur.

#### Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë se për përgatitjen e pasqyrave financiare të Komunës përfshihen procedurat dhe mjetet që janë të dizajnuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, i përmbledhur dhe përshtatshëm i raportuar në pasqyrat financiare. Komuna duhet gjithashtu të përgatis pasqyrat financiare në gjuhën serbe.

Sa i përket shpalosjes së pagesave nga palët e treta, ne rekomandojmë që Komuna të mbledhë informacione nga Ministri të ndryshme që kanë regjistruar këto pagesa dhe të përditësojë regjistrimet e tyre. Për më shumë për pagesat që nuk vijnë nga Ministrinë ne rekomandojmë që zyrtarët e lartë të Komunës të konfirmojnë çdo pagesë / donacion për të cilën ata kanë informacion në çdo periudhë raportuese.

## VIII.2 Auditimi i Brendshëm

### Të Gjeturat

Komuna nuk ka krijuar një Komitet Auditimi deri më 31 Dhjetor 2011.

#### **Rekomandimi 9**

Kryetari i Komunës duhet të konsiderojë krijimin e një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë 'udhëheqje të korporatës. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime si më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;
- Plani i auditimit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditit të brendshëm.

## **IX. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës së Istogut**

### **Konkluzionet e përgjithshme**

Siç u diskutua në këtë raport, përmirësime duhet të bëhen në fushat e pagesave nga palët e treta, të hyrat, prokurimit, trajtimin e të arkëtueshmeve, pagimi i detyrimeve brenda afatit të kërkuar, mirëmbajtja e regjistrave dhe shpalosja e duhur e pasurive kapitale dhe jo kapitale dhe themelimi i komitetit të auditimit .

### **Rekomandimi i përgjithshëm**

- Pasqyrat Financiare të përgaditen në përputhje me udhëzimet administrative aktuale dhe SNKSP;
- Të mbahet një listë gjithëpërfshirëse për pagesat nga palët e treta;
- Të mbaje një regjistër i detajuar dhe gjithëpërfshirës për pronë, objekte dhe pajisje;
- Të bëhet implementimi i një sistemi të faturimit automatik për të gjitha llojet e të hyrave, të bëhet barazimi i të dhënave të mbajtura në kontabilitet me ato të zyrtarit të të hyrave apo departamenteve operacionale dhe të ndërmerren masa për rritjen e arkëtimit të të hyrave nga taksat e ndryshme;
- Të përmirësohen kontrollet mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin dhe kërkesat e rregulloreve lokale;
- Të bëhen të gjitha përpjekjet që të paguhen faturat e pakryera brenda vitit fiskal; dhe
- Të krijohet një Komiteti Auditimi.

## Shtojca 1. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

**9.** Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

**10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet**

materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

**11. Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

**12.** Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

(a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;

(b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

(c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

**13. Opinioni i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

**14. Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

**15. Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

**16.** Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca 2: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimi i dhene	Rekomandimi i implementuar plotesisht	Pjeserisht i adresuar	I pa adresuar
VI. Pasqyrat Financiare - Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informacionit	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të siguroj se për përgatitjen e pasqyrave financiare të Komunës përfshihen procedurat dhe mjetet që janë të dizajnuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, i përmbledhur dhe përshtatshëm i raportuar në pasqyrat financiare.</p> <p>Komuna duhet gjithashtu të përgatise pasqyrat financiare në gjuhën serbe. Persa i përket shpalosjes së pagesave nga palët e treta, ne rekomandojmë që Komuna të mbledhë informacione nga entitete të ndryshme që kanë regjistruar këto pagesa dhe të përditësojë regjistrimet e tyre. Për më shumë për pagesat që nuk vijnë nga Ministrinë ne rekomandojmë që zyrtarët e lartë të Komunës të konfirmojnë çdo pagesë / donacion për të cilën ata kanë informacion në çdo periudhë raportuese.</p>		Komuna ka shpalosur pjesërisht pagesat nga palët e treta.	
VII.1 Te ardhurat	Mbajtja e një sistemi të automatizuar të faturimit për të gjitha llojet e tatimeve			I pa adresuar



<b>Komponenti i Auditimit</b>	<b>Rekomandimi i dhene</b>	<b>Rekomandimi i implementuar plotesisht</b>	<b>Pjeserisht i adresuar</b>	<b>I pa adresuar</b>
VII.1 Te ardhurat	Të kryhet barazimi i të hyrave ndërmjet zyrtarit të të hyrave vetanake dhe departamenteve operacionale			I pa adresuar
VII 2.2 Blerjet përmes Prokurimit	Ne identifikuam një numër mos-perputhesh në fushën e shpenzimeve, duke përfshirë jo-pajtueshmerite me ligjet nr 03 / L-241 dhe 04 / L 042 'Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë', të dyja në fuqi dhe periudha të ndryshme kohore brenda vitit 2011, jo-pajtueshmeri në fushat e pagave dhe mëditjeve dhe blerjeve te tjera. Këto jo-pajtueshmeri lidhen me procedurat e kërkuara, të cilat nuk ishin kryer dhe dokumentuar nga Komuna			I pa adresuar
VIII. Kontrolli i Menajmentit	Te themelohet Komiteti i Auditimit			Vendimi për të formuar një komitet auditimi është marrë. Për shkak të mungesës së disponueshmërisë së buxhetit, vendimi ende nuk është zbatuar ende.

### Shtojca 3. Komentet e Menaxhmentit të Komunës së Istogut dhe përgjigja e KPMG-së

<b><u>Rekomandimet</u></b>	<b>Pajtohem</b>	<b>Pajtohem pjesërisht</b>	<b>Nuk pajtohem</b>	<b>Komentet e Komunës</b>	<b>Komentet e KPMG-së</b>
<p><b><u>Rekomandimi 1:</u></b></p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të siguroj se për përgatitjen e pasqyrave financiare të Komunës përfshihen procedurat dhe mjetet që janë të dizajnuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, i përmbledhur dhe përshtatshëm i raportuar në pasqyrat financiare. Komuna duhet gjithashtu të përgatis pasqyrat financiare në gjuhën serbe.</p> <p>Sa i përket shpalosjes së pagesave nga palë të treta, ne rekomandojmë që Komuna të mbledhë informacione nga Ministri të ndryshme që kanë regjistruar këto pagesa dhe të përditësojë regjistrimet e tyre. Për më shumë për pagesat që nuk vijnë nga Ministritë ne rekomandojmë që zyrtarët e lartë të Komunës të konfirmojnë çdo pagesë / donacion për të cilën ata kanë informacion në çdo periudhë raportuese.</p>	X			Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të implementuar rekomandimet tuaja.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.

<b><u>Rekomandimet</u></b>	<b>Pajtohemi</b>	<b>Pajtohemi pjesërisht</b>	<b>Nuk pajtohemi</b>	<b>Komentet e Komunës</b>	<b>Komentet e KPMG-së</b>
<p><b><u>Rekomandimi 3:</u></b>  Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për te përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe te faturimit ne mënyre që te siguroj kontrole te sigurta, eficiente dhe efektive ne faturim dhe te hyra. Përmirësimi i procedurave te lidhura me keto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit te monitoroj dhe menaxhoj rreziqet e mëdha dhe te siguroj qe vendimet ne lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e te hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës te konsideroj pikat si ne vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Implementimin e një sistemi te faturimit qe përfshin detaje te përditësuara për pagesit, adresën e tyre te tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes se te hyrave nga këta pages. Qasje ne informacion te tille duhet te kenë vetëm një numër te limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.</li> <li>•Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifit dhe normat e taksave ne sistem ne mënyre qe të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet te autorizohet dhe te rishikohet.</li> <li>•Të ekzistojë një lidhje automatike ne mes te sistemit te faturimit dhe sistemit te kontabilitetit ne mënyre qe informacioni te procesohet automatikisht ne librin kryesor te kontabilitetit.</li> </ul>	X			Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të implementuar rekomandimet tuaja.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.

<b><u>Rekomandimet</u></b>	<b>Pajtohemi</b>	<b>Pajtohemi pjesërisht</b>	<b>Nuk pajtohemi</b>	<b>Komentet e Komunës</b>	<b>Komentet e KPMG-së</b>
<p><b><u>Rekomandimi 3: (vazhdim)</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Të ushtrojë barazime të rregullta midis dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha tipet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda afatit të caktuar.</li> <li>•Te lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksioneve.</li> </ul>					
<p><b><u>Rekomandimi 4:</u></b></p> <p>Në rekomandojmë Kryetarit të Komunës të siguroj se komuna do të ndermer hapa të metutjeshëm për të përmirësuar procedurat e kontrollit mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat e ligjeve dhe rregulloret lokale.</p>	X			Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të implementuar rekomandimet tuaja.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.

<b><u>Rekomandimet</u></b>	<b>Pajtohemi</b>	<b>Pajtohemi pjesërisht</b>	<b>Nuk pajtohemi</b>	<b>Komentet e Komunës</b>	<b>Komentet e KPMG-së</b>
<p><b><u>Rekomandimi 5:</u></b> Ne rekomandojmë Komunës të sigurojë:</p> <p>Shpalosjen e llogarive të arkëtueshme në mënyrë të detajuar dhe që shënimi të përmbaj të dhëna të sakta mbi debitorët në mënyrë që ti mundësoj Komunës për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.</p>	X			Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të implementuar rekomandimet tuaja.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.
<p><b><u>Rekomandimi 6:</u></b> Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve.</li> <li>• Te përfshije burime shtese ne regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme si praktika më e mire në raste të tilla.</li> <li>•Te bëje numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.</li> <li>•Te bëje përpjekje shtese në lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive.</li> </ul>	X			Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të implementuar rekomandimet tuaja.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.

<b><u>Rekomandimet</u></b>	<b>Pajtohemi</b>	<b>Pajtohemi pjesërisht</b>	<b>Nuk pajtohemi</b>	<b>Komentet e Komunës</b>	<b>Komentet e KPMG-së</b>
<p><b><u>Rekomandimi 7:</u></b></p> <p>Ne rekomandojmë Kryetarit të Komunës të siguroj se komuna do të ndërmerr hapa të metutjeshëm për të përmirësuar procedurat e kontrollit mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të jetë plotësisht në përputhje me kerkesat e ligjeve dhe rregulloret lokale. Duhet të bëhen të gjitha përpjekjet për të bërë pagesat brenda vitit.</p>	X			Në të gjeturat tuaja gjatë auditimit, fletëdergesat nuk i janë bashkangjitura urdhërblerjes dhe urdhërpagesës, ngase fletëdergesat së bashku me raportin e nënshkruar të pranimit kanë mbetur tek njesitë përkatëse pasi që nuk ka pasur zyrtar të ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues për pranimin e mallrave dhe shërbimeve.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.
<p><b><u>Rekomandimi 8:</u></b></p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të siguroj se për përgatitjen e pasqyrave financiare të Komunës përfshihen procedurat dhe mjetet që janë të dizajnuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, i përmbledhur dhe përshtatshëm i raportuar në pasqyrat financiare. Komuna duhet gjithashtu të përgatis pasqyrat financiare në gjuhën serbe.</p> <p>Sa i përket shpalosjes së pagesave nga palë të treta, ne rekomandojmë që Komuna të mbledhë informacione nga Ministri të ndryshme që kanë regjistruar këto pagesa dhe të përditësojë regjistrimet e tyre. Për më shumë për pagesat që nuk vijnë nga Ministritë ne rekomandojmë që zyrtarët e lartë të Komunës të konfirmojnë çdo pagesë / donacion për të cilën ata kanë informacion në çdo periudhë raportuese.</p>	X			Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të implementuar rekomandimet tuaja.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës	Komentet e KPMG-së
<p><b><u>Rekomandimi 9:</u></b></p> <p>- Kryetari i Komunes duhet të konsiderojë krijimin e një funksioni te Auditimit te brendshëm dhe një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standart të lartë ‘udhëheqje të korporatës’. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;</li> <li>• Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;</li> <li>• Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;</li> <li>• Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;</li> <li>• Plani i auditit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditit të brendshëm.</li> </ul>	X			Do të bëhen të gjitha përpjekjet për të implementuar rekomandimet tuaja.	Komuna është pajtuar me gjetjet tona.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

KOMUNA ISTOG  
OPSTINA ISTOG  
MUNICIPALITY ISTOG

**Pasqyrat Financiare**

Për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2011

Istog, 2012



## Neni 11. DEKLARATË PËR PREZANTIMIN E PASQYRAVE FINACIARE

Për: **Lulzim Ismajli, General Treasury Director**

Nga: **Administrative and Financial Chief Officer**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048 dhe ligjin nr. 03/L-221 për ndryshim plotësimin e LMFPP dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e pasqyrave financiare të Buxhetit të Konsoliduarx të Kosovës ("BKK") të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2011.

Ne konfirmojmë, për sa kemi njohuri dhe besim, që:

Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësinë apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta. Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.

Nuk ka llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2011.

Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.

Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.

Të gjitha huatë për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.

Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Komunat duhet të dërgojnë raportet te komisioni për buxhet dhe financa të Asamblesë Komunale.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011 të Komunës së Istogut.

Data: 22.06.2012  
Nënshkrimi dhe Vula:

Z. Osman Sadikaj  
Zyrtari Kryesor Financiar



Data:  
Nënshkrimi dhe Vula:

22.06.2012  
Z. Haki Rugova

Zyrtari Kryesor Administrativ-  
Kryetari i Komunës

## Komuna Istog

### Neni 12. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin qe mbaron me 31 Dhjetor 2011

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënime	2011		2010		2009	
	Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit		Llogaria e vetme e Thesarit	
	BKK EUR '000	Pagesa nga palët e treta të jashtme EUR '000	BKK EUR '000	Pagesa nga palet e treta te jashtme EUR '000	BKK EUR '000	Pagesa nga palet e treta te jashtme EUR '000
<b>Burimet e fondeve</b>						
Granti Qeveritar	2	6,479	-	5,315	-	4,396
Të hyrat vetanake	3	743	-	828	-	789
<i>Fondi për qëllime të dedikuara</i>						
Grantet e përcaktuara të donatorëve	4	50	-	544	-	717
Fondi i huazimeve	5	-	-	-	-	-
Pranimet tjera	6	-	-	-	-	-
			3,956			
<b>Totali</b>		<b>7,272</b>	<b>3,956</b>	<b>6,687</b>	<b>-</b>	<b>5,902</b>
<b>Shfrytëzimi i fondeve</b>						
<i>Operacionet</i>						
Pagat dhe mëditjet	7	4,133	-	3,306	-	2,936
Mallrat dhe shërbimet	8	601	-	661	-	625
Shërbimet komunale	9	130	-	146	-	120
		<b>4,864</b>	<b>-</b>	<b>4,113</b>	<b>-</b>	<b>3,681</b>
<i>Transferet</i>						
Transferet dhe subvencionet	10	96	-	110	-	196
<i>Shpenzimet kapitale</i>						
Prona, ndërtesa dhe paisjet	11	2,312	-	2,464	-	2,025
Pagesat tjera	12	-	3,956	-	-	-
Kthimi i huazimeve	13	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>		<b>7,272</b>	<b>3,956</b>	<b>6,687</b>	<b>-</b>	<b>5,902</b>

## Komuna e Istogut

### Neni 13. Raporti i ekzekutimit të buxhetit për vitin që mbaron më 31 Dhjetor 2011

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

Shënime	2011				2010	2009
	Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti Final (Ndarja) B	Realizimi C	Varianca D=C-B	Realizimi E	Realizimi F
	EUR '000	EUR '000	EUR '000	EUR '000	EUR '000	EUR '000
<b>Hyrjet e parasë së gatshme në llogari të Thesarit</b>						
Tatimet	14	-	-	-	-	-
Të hyrat vetanake	15	764	989	855	(134)	715
Donacionet	16	-	81	50	(31)	544
Pranimet kapitale	17	-	-	-	-	-
Fondi i Privatizimit	18	-	-	-	-	-
Huazimet	19	-	-	-	-	-
Tjera	20	-	-	-	-	-
<b>Pranimet totale të mbledhura për BKK-në</b>		<b>764</b>	<b>1,070</b>	<b>905</b>	<b>(165)</b>	<b>1,259</b>
<b>Daljet e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit</b>						
Pagat dhe mëditjet	21	4,102	4,207	4,133	(74)	3,306
Mallrat dhe shërbimet	22	590	634	601	(33)	661
Shërbimet komunale	23	131	131	130	(1)	146
Transferet dhe subvencionet	24	94	118	96	(22)	110
Shpenzimet kapitale	25	2,314	2,509	2,312	(197)	2,464
Fondi i Privatizimit	26	-	-	-	-	-
Kthimi i huazimeve		-	-	-	-	-
Tjera	27	-	-	-	-	-
<b>Totali i pagesave i bërë nga BRK nëpërmes LIVTh</b>		<b>7,231</b>	<b>7,599</b>	<b>7,272</b>	<b>(327)</b>	<b>6,687</b>

Total *Granti i Përgjithshëm* në shumë prej 6,466 mijë Euro për buxhetin fillestar, 6,528 mijë Euro për buxhetin final dhe 6,479 mijë Euro për realizimin në vitin 2011 (2010: 5,315 mijë Euro; 2009: 3,336 mijë Euro) nuk janë përfshirë në seksionin *Hyrjet e parasë së gatshme në llogari të thesarit* në tabelën e mësipërme, edhe pse këto fonde janë përdorur për të paguar shumicën e shpenzimeve të prezentuara në seksionin *Daljet e parasë së gatshme nga llogaria e thesarit*. Në vitet e paraprake, këto shuma ishin prezentuar si kategori e veçante brenda seksionit *Hyrjet e parasë së gatshme në llogari të thesarit* në Nenin 13 Raporti i ekzekutimit të buxhetit.

# **Komuna e Istogut**

## **Neni 14. Shpalosja e shënimeve**

### **31 Dhjetor 2011**

*(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)*

#### **Shënimi 1**

##### **1.1 Bazë për përgatitje të Pasqyrave Financiare**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik ('SNKSP') Bazuar në Paranë e Gatshme *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2011 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*.

Politikat kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente gjatë gjithë periudhës raportuese.

##### **1.2 Entiteti raportues**

Pasqyrat financiare janë për sektorin e entitetit publik: Komuna e Istogut ('Komuna'). Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë (03/L-048 dhe 03/L211). Komuna e Istogut është e kontrolluar nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet financiare janë të kontrolluara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

##### **1.3 Pagesat nga palët e treta**

Komuna përfiton nga mallrat dhe shërbimet e blera në emër të saj si rezultat i pagesave me para të gatshme nga palët e treta gjatë periudhës raportuese. Pagesat e bëra nga palët e treta për Komunën nuk përbëjnë pranime ose pagesa me para të gatshme por Komuna është përfituese e tyre. Komuna prezanton ndaras pagesat sipas burimit në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave me para të gatshme.

##### **1.4 Llogaritë e vetme të Thesarit**

Komuna nuk operon në llogaritë e saja bankare. Qeveria ka funksion te centralizuar të Thesarit e cila administron pranimin e parasë të marra nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit fiskal. Pagesat e bëra në këtë llogari në lidhje me Komunën janë të prezantuara në kolonën e Llogaritë e Vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave me para të gatshme.

##### **1.5 Kthimi i shpenzimeve nga viti paraprak**

Fondet e rikthyera në BKK nga viti i kaluar janë regjistruar si pranime në vitin aktual e jo si reduktime të shpenzimeve të vitit kur ka ndodh shpenzimi.

##### **1.6 Monedha raportuese**

Monedha raportuese është Euro (EUR)

##### **1.7 Data e autorizimit**

Pasqyrat Financiare janë të autorizuar të lëshohen dhe të aprovohen më 31 Janar 2012 nga Osman Sadikaj.

**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 2 Ndarjet e fondit të përgjithshëm**

Klasifikimi ekonomik	2011	2010	2009
	EUR '000	EUR '000	EUR '000
Pagat dhe rrogat	4,116	3,264	2,878
Mallrat dhe shërbimet	492	466	460
Shërbimet komunale	130	126	112
Subvencionet dhe transferet	-	-	-
Shpenzimet kapitale	1,741	1,459	946
<b>Totali</b>	<b>6,479</b>	<b>5,315</b>	<b>4,396</b>

**Shënimi 3 Të hyrat vetana ke**

Klasifikimi ekonomik	2011	2010	2009
	EUR '000	EUR '000	EUR '000
Pagat dhe rrogat	17	42	58
Mallrat dhe shërbimet	83	172	164
Shërbimet komunale	-	20	8
Subvencionet dhe transferet	96	110	196
Shpenzimet kapitale	547	484	363
<b>Totali</b>	<b>743</b>	<b>828</b>	<b>789</b>

**Shënimi 4 Grantet e përcaktuara të donatorëve**

Klasifikimi ekonomik	2011	2010	2009
	EUR '000	EUR '000	EUR '000
Pagat dhe rrogat	-	-	-
Mallrat dhe shërbimet	26	23	1
Shërbimet komunale	-	-	-
Subvencionet dhe transferet	-	-	-
Shpenzimet kapitale	24	521	716
<b>Totali</b>	<b>50</b>	<b>544</b>	<b>717</b>

**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 5 Fondi i huazimeve**

	2011	2010	2009
Huadhënësi	EUR '000	EUR '000	EUR '000
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-

Nuk ka fonde të huazuara për vitin 2011.

**Shënimi 6 Pranimet e tjera**

Nuk ka pasur pranime të tjera gjatë vitit 2011.

**Shënimi 7 Pagat dhe rrogat**

Përshkrim	2011			Totali EUR'000	2010	2009
	NFP EUR '000	THV EUR'000	GPD EUR'000		EUR'000	EUR'000
<b>Payments</b>						
Neto pagat	3,554	17	-	3,571	2,883	2,493
Pagesat për sindikatat 0.10% te 0.50%	12	-	-	12	9	8
Pagesat për punë jashtë orarit	-	-	-	-	-	-
Pagesat për punë me orar të shkurtër	-	-	-	-	-	-
Pagesat me punë për ndërrim të natës	-	-	-	-	-	-
Pagesat neto për pushim të lehonisë	-	-	-	-	-	-
Mëditjet e delegatëve dhe komisionerëve	-	-	-	-	-	71
Pagesat për punëtorët me kontrat	-	-	-	-	-	-
Tatimi në të ardhurat personale	156	-	-	156	101	84
Pagesat e kontributit pensional nga punëdhënësi	197	-	-	197	155	140
Pagesat e kontributit pensional nga i punësuar	197	-	-	197	158	140
Vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>4,116</b>	<b>17</b>	<b>-</b>	<b>4,133</b>	<b>3,306</b>	<b>2,936</b>

**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 8 Mallrat dhe shërbimet**

Përshkrimi	2011			Totali EUR '000	2010	2009
	NFP EUR '000	THV EUR '000	GPD EUR '000		EUR '000	EUR '000
<b>Pagesat nga BKK</b>						
Shpenzimet e udhëtimit	23	-	-	23	23	14
Shpenzimet e telekomunikimit	2	1	-	3	10	32
Shërbimet për shërbime të kontraktuara	60	13	11	84	62	95
Mobiljet dhe paisjet nën EUR 1,000	43	2	-	45	41	66
Mobiljet dhe paisjet tjera 1,000 – 5,000 EUR	-	38	12	50	-	-
Blerjet tjera të mallrave dhe shërbimeve	89	9	-	98	181	123
Derivate dhe lëngje djegëse	161	-	2	163	193	166
Shërbimet financiare	-	2	-	2	-	-
Shpenzimet e regjistrimit dhe sigurimeve	9	-	-	9	11	10
Mirëmbajtja	86	9	-	95	-	-
Qiraja	-	2	-	2	106	112
Shpenzimet e marketingut	6	4	1	11	12	-
Shpenzimet e përfaqësimit	13	3	-	16	22	7
<b>Totali</b>	<b>492</b>	<b>83</b>	<b>26</b>	<b>601</b>	<b>661</b>	<b>625</b>

**Shënimi 9 Shërbimet komunale**

Përshkrimi	2011			Totali EUR '000	2010	2009
	NFP EUR '000	THV EUR '000	GPD EUR '000		EUR '000	EUR '000
Rryma	58	-	-	58	-	-
Uji	52	-	-	52	-	-
Mbeturinat	11	-	-	11	-	-
Telefon	9	-	-	9	-	-
Shpenzimet komunale	-	-	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>130</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>130</b>	<b>146</b>	<b>120</b>

**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 10 Transferet dhe Subvencionet**

Përshkrimi	2011			Totali EUR '000	2010	2009
	NFP EUR '000	THV EUR '000	GPD EUR '000		EUR '000	EUR '000
<b>Pagesat</b>						
Subvencionet për entitete publike	-	6	-	6	10	38
Subvencionet për entitete kulturore	-	22	-	22	-	-
Subvencionet për entitete jo-publike	-	16	-	16	35	20
Transfere për qeveri tjera	-	-	-	-	-	-
Pagesat për përfituesit individual	-	52	-	52	65	138
Pensionet bazë	-	-	-	-	-	-
Pensionet invalide	-	-	-	-	-	-
Pensionet ose ndihmat sociale	-	-	-	-	-	-
Pensionet e TMK	-	-	-	-	-	-
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)	-	-	-	-	-	-
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)	-	-	-	-	-	-
Pagesat për invalidët e luftes	-	-	-	-	-	-
Pagesat për invalidët civil	-	-	-	-	-	-
Pagesat për familjet e viktimave të luftës	-	-	-	-	-	-
Pensionet e përkohshme të Trepçës	-	-	-	-	-	-
Vendimet gjyqësore	-	-	-	-	-	-
<b>Total i</b>	<b>-</b>	<b>96</b>	<b>-</b>	<b>96</b>	<b>110</b>	<b>196</b>

**Shënimi 11 Pronat, Objektet dhe Paisjet**

Përshkrimi	2011			Total EUR '000	2010	2009
	NFP EUR '000	OSR EUR '000	DDG EUR '000		EUR '000	EUR '000
<b>Pagesat</b>						
Ndërtesat	250	56	-	306	432	723
Ndërtimi i rrugëve	742	105	21	868	979	467
Kanalizimi	125	126	3	254	-	184
Ujësjet	130	6	-	136	-	69
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi	40	50	-	90	100	66
Paisjet me vlerë mbi 1000 EUR	47	21	-	68	227	-
Automjete transporti	-	-	-	-	-	-
Makineria	40	24	-	64	42	24
Kapitalet tjera	367	159	-	526	684	492
<b>Totali</b>	<b>1,741</b>	<b>547</b>	<b>24</b>	<b>2,312</b>	<b>2,464</b>	<b>2,025</b>



**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 12 Pagesat tjera**

<b>Investitori</b>	<b>Përshkrimi i pagesës</b>	<b>2011 EUR'000</b>	<b>2010 EUR'000</b>	<b>2009 EUR'000</b>
MPTT	Asfaltimi i rrugës Tomoc -Kovrage	31	-	-
MPTT	Asfaltimi i rrugës Dubove e Vogël	224	-	-
MMS	Rregullimi i parkut të Studenices	20	-	-
MKK	Ujësjellesi Osojan-Tuqep-Kerrnin	117	-	-
MQL	Ndërtimi i katit të Komunës	200	-	-
MPMS	Mirëmbajtja e rrugëve	26	-	-
USAID - DEMI	Ndriqimi public në Vrellë	31	-	-
USAID - DEMI	Kubezimi i trotuarit ne rrugen Uçk-Istog	32	-	-
MASHT	Ndërtimi i objektit të shkollës “B.Curri”	1,750	-	-
MASHT	Ndërtimi i salles së sportit”Ismail Qemali”	270	-	-
KE	Ndërtimi i objektit të shkollës në Cerrocë	350	-	-
IDEP	Kabineti i Informatikës në Rakosh	9	-	-
IDEP	Mjete konkretizimi, biologji, fizikë dhe lektyra shkollore në Zallq	7	-	-
IDEP	Mjete laboratory në Llukac i Begut	7	-	-
BB	Mjete laboratory në Gurrakoc	882	-	-
<b>Totali</b>		<b>3,956</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Shënimi 13 Kthimi i huazimeve**

<b>Përshkrimi</b>	<b>2011 EUR '000</b>	<b>2010 EUR '000</b>	<b>2009 EUR '000</b>
Huadhënësi 1	-	-	-
Huadhënësi 2	-	-	-
Huadhënësi 3	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Shënimi 14 Tatimet**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Shënimi</b>	<b>2011 EUR '000</b>	<b>2010 EUR '000</b>	<b>2009 EUR '000</b>	<b>% of total 2011</b>	<b>% change from 2010</b>
Të hyrat tatimore 1		-	-	-	%	%
Të hyrat tatimore 2		-	-	-	%	%
Të hyrat tatimore 3		-	-	-	%	%
<b>Totali</b>		<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0%</b>	<b>%</b>

Vërejtje: Tabela ka të bëjë vetëm me tatimet të cilat lidhen me Doganën dhe ATK-në.

**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 15 Të hyrat vetanakes**

Përshkrimi	2011	2010	2009	% i	%
	EUR '000	EUR '000	EUR '000	totalit 2011	ndryshimi nga 2010
Çertifikatat e lindjes	40	48	40	5%	-17%
Çertifikatat e martesës	10	9	8	1%	7%
Çertifikatat e vdekjes	1	-	-	0%	0%
Çertifikatat e tjera zyrtare	17	17	30	2%	0%
Tatimi për verifikimin e dokumenteve	3	3	4	0%	-13%
Tatimi administrativ	4	5	5	0%	-18%
Tatimi për participim në tender	2	3	3	0%	-23%
Tatimi komunal për licenca ndertimi	94	96	36	11%	-2%
Tatimi për përdorimin e pronës publike	7	-	-	1%	0%
Inspktimi në teren për matje	57	55	52	7%	4%
Tatimi në pronë	220	186	170	26%	18%
Qiraja për prona publike	6	5	8	1%	22%
Licenca të tjera për biznes	17	13	7	2%	32%
Licenca individuale	8	6	8	1%	25%
Licenca për shitje të rrugës	4	5	8	1%	-14%
Licenca për shërbime profesionale	12	7	10	1%	71%
Licenca për lojra të fatit	1	-	-	0%	0%
Licenca për shitje: me pakicë, vajrave dhe naftës	3	-	2	0%	0%
Licenca për shitje të pijeve alkoholike	-	-	-	0%	0%
Licenca për hoteleri	8	3	2	1%	163%
Tatimi për pranim teknik	1	-	-	0%	0%
Tatimi për regjistrimin e automjeteve	59	53	51	7%	11%
Tatimi për ndryshim të destinacionit të tokës	1	3	83	0%	-63%
Participimi në Arsim dhe Shëndetsi	90	84	91	11%	7%
Gjobat rrugore	29	41	63	3%	-28%
Tatimi i pylltarisë	17	3	10	2%	473%
Penale gjyqsore	98	64	78	12%	54%
Pjesmarrja e komunitetit	46	-	-	100%	0%
Të ardhurat nga përdorimi i tokës	-	2	2	0%	-100%
Të ardhurat nga shitja e mallrave	-	2	6	0%	-100%
Të ardhurat nga shërbimet publike	-	2	3	0%	-100%
<b>Total i</b>	<b>855</b>	<b>715</b>	<b>780</b>	<b>100%</b>	<b>20%</b>

**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 16 Grantet dhe ndihma**

<b>Organizata</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>2011 EUR '000</b>	<b>2010 EUR '000</b>	<b>2009 EUR '000</b>
Participimi i komunitetit	Asfaltimi dhe kanalizimi	46	-	30
UNOPS	Regjistrimi i Polullsisë	3	-	-
Banka Botërore	Grantet nga Shkolla Fillore	27	-	-
UNDP	Bashkë-financimi dhe mbështetja e re të projektit të RKK	5	-	57
UNDP	Kthimi i komunitetit Serb në Syne	-	534	-
Banka Botërore	Paisje shkollore	-	10	-
UNDP	RAE ndihmë komunale	-	-	630
<b>Totali</b>		<b>81</b>	<b>544</b>	<b>717</b>

**Shënimi 17 Pranimet kapitale**

<b>Natyra e pasurive</b>	<b>Fitimet nga shitja</b>		
	<b>2011</b>	<b>2010</b>	<b>2009</b>
	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>
Toka	-	-	-
Ndërtesa	-	-	-
Infrastruktura	-	-	-
Makineri	-	-	-
Paisjet	-	-	-
Automjete transporti	-	-	-
Tjera	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Shënimi 18 Fondi i privatizimit**

<b>NPSH</b>	<b>Fitimet nga privatizimi</b>		
	<b>2011</b>	<b>2010</b>	<b>2009</b>
	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>
NPSH #1	-	-	-
NPSH #2	-	-	-
NPSH #3	-	-	-
NPSH #4	-	-	-
NPSH #5	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Komuna e Istogut**  
**Neni 14. Shpalosja e shënimeve**  
**31 Dhjetor 2011**

(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)

**Shënimi 19      Huazimet**

<b>Përshkrimi</b>	<b>2011</b>	<b>2010</b>	<b>2009</b>
	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>
	-	-	-
Huadhënësi 1	-	-	-
Huadhënësi 2	-	-	-
Huadhënësi 3	-	-	-
Huadhënësi 4	-	-	-
Huadhënësi 5	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

**Shënimi 20      Tjera**

<b>Natyra e pranimit</b>	<b>2011</b>	<b>2010</b>	<b>2009</b>
	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>	<b>EUR '000</b>
Depozitat e lojërave të fatit	-	-	-
Depozitat e Komisionit Rregullativ	-	-	-
Depozita e Ministrisë së Drejtësisë	-	-	-
Depozitat tjera	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

# **Komuna e Istogut**

## **Neni 14. Shpalosja e shënimeve**

### **31 Dhjetor 2011**

*(Shumat në mijë EUR, vetëm nëse përmendet ndryshe)*

#### **Shënimet 21 deri në Shënimin 27**

Për dallim nga shënimet 11-16, këto shënime janë përdorur për të shpjeguar dallimet material ne kolonen D të Raportit të Ekzekutimit të Buxhetit, p.sh. differencat materiale në realizimet buxhetore. Duke u varur nga madhësia e differencës, nuk ka nevojë të ofrohet shpjegime për të gjitha kategoritë.

#### **21. Dallimi ndërmjet pagesave dhe buxhetit final sa i përket pagave dhe rrogave**

Shuma prej EUR 74 mijë ka mbetur e pashpenzuar për arsyet në vijim:

- Shuma prej EUR 15 mijë është alokim shtesë nga Ministria e Financave për të mbuluar deficitin e pritur në kategorinë e Shpenzimeve: Pagat dhe Mëditjet.
- EUR 59 mijë ka mbetur e pashpenzuar sepse plani për të hyrat vetanake dhe pagesat nuk është rishikuar në departamentin e Arsimit dhe Shëndetit për nentor dhe dhjetor 2011 e cila është raportuar me vonesë.

#### **22. Dallimi ndërmjet pagesave dhe buxhetit final për mallra dhe shërbime**

Këto dallime rrjedhin nga dy burime:

-Dallimi me shumë prej EUR 33 mijë është planifikuar për pagesë të performancës në departamentin e shëndetsisë, mirëpo, Ministria e Financave nuk e ka alokuar këtë shumë sepse nuk ka mundur të arrijë marrëveshje me Ministrinë e Shëndetsisë për të formuar planin e pagesës për të përkrahur personelin shëndetsor, në këtë mënyrë dallimi paraqitet si suficit.

#### **23. Dallimi ndërmjet pagesës dhe buxhetit final sa i përket shërbimeve komunale**

Shuma prej EUR 1 mijë ka mbetur e pashpenzuar sepse faturat për shërbime komuna të dhjetorit janë pranuar pas përfundimit të periudhës raportuese.

#### **24. Dallimi ndërmjet pagesës dhe buxhetit final për transfere dhe subvencione**

Për shkak të mungesave të mjeteve Komuna nuk mund ti përdorim pranimet e të hyrave vetanake për nentor dhe dhjetor 2011, ata nuk kanë mundur të paguajnë transferet dhe subvencionet të cilat kanë një shumë prej EUR 22 mijë.

#### **25. Dallimet nëpërmjet pagesës dhe buxhetit final për shpenzimet e kapitalit**

Shpenzimet kapitale janë shpenzuar më pak në shumë prej EUR 197 mijë është përbërë nga dy burime të financimit të cilat nuk janë shpenzuar: 1) Granti Qeveritar me shumë prej EUR 45 mijë, e cila ka mbetur si suficit nga shuma e mbetur nga projektet të cilat janë në tender; dhe 2) të hyrat vetanake me shumë prej EUR 152 mijë poashtu kanë mbetur suficit për arsye se në mungesë të pranimeve nga të hyrat vetanake ne nuk kemi mundur ti paguajme faturat për të hyrat vetanake për nentor dhe dhjetor 2011.

#### **26. Dallimet nëpërmjet pagesës dhe buxhetit final për fondin e privatizimit**

Nuk ka dallim në këtë kategori ekonomike.

#### **27. Dallimet nëpërmjet pagesës dhe buxhetit final për kthimet e huazimeve**

Nuk ka dallim në këtë kategori ekonomike.

## Komuna e Istogut

### Neni 15-20. Shpalosja e shënimeve

31 dhjetor 2011

(Shumat në mijë EUR, vetën nësë thuhet ndryshe)

### Shënimi 28 Pasqyra e faturave (obligimeve) të papaguara të organizatës buxhtore -

### Përmbledhje

		2011
<b>Kategoria Ekonomike</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>EUR '000</b>
11	Pagat dhe mëditjet	4
13141	Shpenzimet për udhëtime zyrtare	1
13210	Rryma	11
13220	Uji	45
13230	Mbeturinat	1
13250	Shpenzimet e telefonit	2
13461	Pastrimi i qytetit	5
13330	Shërbimet postare	9
13620	Ushqim dhe pije	4
13780	Derivate/Naftë	40
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi I automjeteve	3
13610	Paizje për zyrë	5
Nuk është shpalosur ("N/SH")	Blejrje e kurorave	1
N/SH	Publikimet	11
N/SH	Shpenzimet e përfaqësimit	3
